

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Goldcoin” sh.p.k.**

Sot, më datë 17.08.2020, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- **Z. Suraj GOEL** shtetas Indian, lindur më 15.06.1990, banues në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. Z5658910
- **Z. Sahil Goel**, shtetas Indian, lindur më 27.10.1987, banues në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. Z5674242, vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**Neni 1**

**Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“Goldcoin”** Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2**

**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Yzberisht, Hyrja Nr.2, Ap.41 Tiranë me numer pasuire 301/201 +2-41.
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**Neni 3**

**Objekti**

3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

Online marketing, biznes online, konsultim online, platforme e-commerce, ofrim shërbimi të ndryshme edhe të gjithë çfare llojshme, nepermjet telemarketingut. Kerkime tregtare, sondazhe online, tregtim i software, faqe web, import-eksport të mallrave të ndryshme, transport etj.

Shoqëria mund të kryej cdo lloj aktiviteti të ligjshëm në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

**Neni 4**

**Kohëzgjatja**

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100,00 (Një Qind lekë)** dhe është i ndarë në **2 kuote të barabarta vlera nominale e të ciles është 50,00 lekë.**
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët :

**Z. Suraj GOEL** shtetas Indian, lindur më 15.06.1990, banues në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. Z5658910, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 50,00 (Pesëdhjetë lekë), e barabartë me 50% ( Pesëdhjetë) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;

- **Z. Sahil Goel**, shtetas Indian, lindur më 27.10.1987, banues në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. Z5674242, zotërues i 1 një kuote të Shoqërisë, me vlerë 50,00 (Pesëdhjetë lekë), duke përfaqësuar 50% (Pesëdhjetë) të kapitalit themeltar.

- 5.2 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.

- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në

- para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

#### Neni 6

#### Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

#### Neni 7

#### Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:  
- **Z. Sahil Goel**, shtetas Indian, lindur më 27.10.1987, banues në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. Z5674242, me zotesi te plote per te vepruar.
- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Statutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

#### Neni 8

#### Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

- 8.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2020.


### Neni 9

#### Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, miratohet nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare.

#### ORTAKËT

Suraj GOEL



Sahil GOEL

